

MENDIM PAKICE

Unë, komisioneri Olsi Komici, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, kam votuar kundër vendimit të datës 8.6.2021, të marrë nga shumica e trupit gjykues, nëpërmjet të cilit është vendosur shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit, z. Gentian Stoja, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Në vijim do të shpjegoj qëndrimin tim të arsyetuar kundër konkluzioneve dhe vendimit të shumicës së trupit gjykues, pa përsëritur argumentet e dhëna nga vetë subjekti dhe shumica e trupit gjykues, për të cilat kam mbajtur të njëjtin qëndrim. Kundërshtitë e mia në lidhje me vendimmarrjen e shumicës së trupit gjykues kanë të bëjnë me vlerësimin e kriterit të pasurisë, duke i renditur si më poshtë.

I. Vlerësimi i pasurisë

1. Gjendje *cash* në vlerën 1,100,000 (një milion e njëqind mijë) lekë, deklaruar në deklaratën *Vetting* nga kursimet e pagës ndër vite.

Në lidhje me këtë deklaram të subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, shumica e trupit gjykues ka konkluduar se, citoj: “3.20 Nga vlerësimi i deklarimeve periodike vjetore nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar, ndër vite, pakësimin e gjendjes *cash* apo përdorimin e saj si burim për shpenzimet e kryera prej tij. Nga vlerësimi i DPV-së vitit 2015, dorëzuar në mars të vitit 2016, pas procesverbalit të datës 26.1.2016, mbi shpjegimet e subjektit të deklaramit të pasurive, rezulton se nuk deklaroi as gjendjen reale *cash* të atij viti dhe as pakësimin e gjendjes *cash* në atë vit. Në përfundim, trupi gjykues çmon se deklaramet e subjektit janë të pasakta dhe të pamjaftueshme, si dhe nuk ka përfshirë këto vlera për të mbuluar shpenzime të subjektit të rivlerësimit dhe familjes së tij në analizën financiare për vitet 2009 – 2016.”

Në lidhje me këtë konkluzion, jam dakord për sa i përket termit *deklaram i pasaktë* çka lidhet me mosdeklaramet e shtesave dhe pakësimeve të gjendjes *cash* ndër vite nga ana e subjektit, por marrë për bazë faktin se: **a)** nga shumica është pranuar fakti se subjekti i rivlerësimit justifikon burimin e ligjshëm financiar të gjendjes *cash* prej 15,000 euro të deklaruar në deklaratën e pasurisë para fillimit të detyrës të vitit 2009; **b)** është pranuar shpjegimi i subjektit se nga shuma e deklaruar *cash* në vitin 2009 prej 15,000 eurosh, 700,000 lekë janë përdorur për blerjen e automjetit tip “Volkswagen” në vitin 2012; **c)** në këtë pikë të vendimit nuk është pasqyruar ndonjë analizë financiare ku të jetë konkluduar me pamundësi financiare nga subjektit dhe e personit të lidhur me të apo me mosdeklaram pasurie në deklaratën *Vetting*, që të mund të konkludohet me deklaram të pamjaftueshëm; **ç)** kronologjia e deklaramit të gjendjes *cash* nga subjekti i rivlerësimit nëpër deklaramet e pasurisë, si dhe përgjatë hetimit, që konsiston në deklaramin në deklaratën për herë të pasurisë të shumës *cash* prej 15,000 eurosh, pagesën nga kjo shumë të blerjes së mjetit tip “V.” në vitin 2012, pagesën prej rreth 100,000 lekësh për shpenzime varrimi për të atin, deklaruar në DIPP-në e vitit 2015 dhe shtimi i kursimeve *cash* për 200,000 lekë, deklaruar në DIPP-në e vitit 2016, i korrespondon deklaramit përfundimtar të gjendjes *cash* prej 1,100,000 lekësh në deklaratën *Vetting*, për rrjedhojë jam kundër konkluzionit të shumicës së trupit gjykues se deklaramet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me gjendjen *cash* janë dhe të pamjaftueshme.

Në lidhje me rubrikën “Gjetje të tjera”

2. Kursime cash në vlerën 4,440,000 (katër milionë e katërqind e dyzet mijë) lekë – deklaruar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në Deklaratën e Interesave Private para fillimit të detyrës, datë 29.12.2009, të disponuara nga prindërit e saj, nga të ardhurat nga qiraja e apartamentit të banimit në rrugën “****”, Durrës, lëshuar me qira që në vitin 1992.

Në lidhje me argumentet dhe konkluzionin e shumicës së trupit gjykues për këtë pikë se, citoj: “2.10 Në përfundim, trupi gjykues çmon se shpjegimet e subjektit mbeten deklarative dhe të paprovuara në ndonjë formë ligjore apo nëpërmjet deklarimeve periodike vjetore. Po ashtu, trupi gjykues çmon se mbetet e paprovuar mundësia për krijimin e shumës 4,440,000 (katër milionë e katërqind e dyzet mijë) lekë me burim nga qiradhënia e një pasurie, e cila vlerësohet modeste, jo në zonë bregdetare (ndodhet në qytet) pa konsumime të energjisë elektrike apo ujësjellësit dhe pa ndonjë dokument provues se marrëdhënia e qiradhënies ka ekzistuar. Edhe nëse merret në konsideratë një qiradhënie sezonale, sipas pretendimeve të subjektit, përsëri vlera prej 4,440,000 (katër milionë e katërqind e dyzet mijë) lekësh konsiderohet në çmim të trupit gjykues, e lartë dhe e pamundur për t’u krijuar, referuar dokumentacionit të administruar dhe provave të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit që kjo trupë ka administruar.

2.11 Në këto kushte, trupi gjykues çmon se personi i lidhur me subjektin ka bërë deklaram të rremë në deklaratën periodike vjetore para fillimit të detyrës, të plotësuar nga subjekti i rivlerësimit dhe se subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar me vërtetësi pasuritë dhe të ardhurat e tij në deklaratimet periodike vjetore, si dhe në deklaratën Vetting. Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e germës “c”, të pikës 5, të nenit 33, pasi ka fshehur në deklaratën Vetting të dhëna lidhur me këtë pasuri.”, nuk jam dakord, duke dhënë shpjegimet si më poshtë:

1. Shuma prej 4,400,000 lekësh është deklaruar në deklaratën për herë të parë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, e vitit 2009 nga ana e personit të lidhur, bashkëshortes së tij, si shumë e krijuar nga dhënia me qira nga prindërit e saj të një apartamenti, që ata kanë në pronësi në qytetin e Durrësit, për periudhën 1992-2007. Kjo shumë nuk është deklaruar nga personi i lidhur me subjektin, bashkëshortja e tij, as në pronësi të saj dhe as si e dhuruar asaj. Kjo përforcohet edhe me faktin se në formularin e deklaramit, në kolonën “pjesa në %”, nuk është vendosur asnjë shënim nga bashkëshortja e subjektit. Pra, nuk ka asnjë *indicie* apo provë që të vërtetojë se shuma prej 4,400,000 lekësh të jetë në pronësi të subjektit të rivlerësimit apo personit të lidhur me të, bashkëshortes së tij.

2. Nga personi i lidhur me subjektin, bashkëshortja e tij, në DIPP-të e viteve 2010 dhe 2011 janë deklaruar të ardhura të krijuara nga qiraja e apartamentit në Durrës gjatë sezonit të plazhit qershor – shtator, përkatësisht në shumën 250,000 lekë për çdo vit, kurse për vitet 2012-2013 në DIPP-të përkatëse është deklaruar si e ardhur nga dhënia me qira e apartamentit në sezonin e plazhit, maj – tetor, shuma prej 350,000 lekësh për secilin vit. Edhe mbi këto të ardhura nuk është deklaruar pjesë në përqindje nga bashkëshortja e subjektit, për rrjedhojë nuk mund të konsiderohen në pronësi të saj. Në DIPP-në e vitit 2014 e në vazhdim, bashkëshortja e subjektit nuk deklaroi më të ardhura nga qiraja në lidhje me këtë apartament.

Deklarimi i të ardhurave nga qiraja në deklaratën për herë të parë të pasurisë të vitit 2009, si dhe në DIPP-të 2010-2013, marrë për bazë edhe pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016¹, sipas së cilës deklarimet/deklaratat mund të përdoren si provë, krijojnë bindjen se marrëdhënia e qirasë ka ekzistuar, e për rrjedhojë, edhe të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga kjo marrëdhënie.

Marrë shkas nga shpjegimet e subjektit se apartamenti jepej me qira në periudhën e plazhit e për më tepër me qiramarrës të ndryshëm brenda të njëjtit vit, kjo lloj marrëdhënie qiradhënës – qiramarrës, si dhe provimi i ekzistencës së marrëdhënies së qirasë, në konsideratë edhe të nenit 803, paragrafi 4 i Kodit Civil, sipas të cilit, kontrata e qirasë për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë, nuk ka qenë kusht detyrues për t'u bërë në formë shkresore ndërmjet palëve.

Në rast se do të përlllogarisim qiranë vjetore që i korrespondon shumës 4,400,000 lekë për periudhën e pretenduar të dhënë me qira 1992 – 2007, rezulton të jetë përfituar një qira vjetore prej rreth 275,000 lekë/vit. Kjo vlerë që është paksa më e lartë se vlera prej 250,000 lekë/vit e deklaruar si qira vjetore për vitet 2010 - 2011 dhe dukshëm më e ulët se vlera 350,000 lekë/vit e deklaruar për periudhën 2012 – 2013, krijon bindjen se shuma prej 4,400,000 lekë është më se e mundur të kursehet përgjatë një periudhe 16-vjeçare (1992 – 2007), marrë në konsideratë edhe faktin se kemi të bëjmë me një shtëpi në qytet bregdetar, të dhënë për turizëm dhe qiraja për këtë rast është shumë më e lartë sesa qiradhënia e një apartamenti në kushte normale dhe për periudha të gjata kohore. Gjithashtu është shumë i rëndësishëm edhe fakti se kemi të bëjmë me një apartament banimi me një sipërfaqe të konsiderueshme prej 84.33 m² (2+1), çka do të thotë ndikim i drejtpërdrejtë në aplikimin e një qiraje më të lartë sesa në rastin e një apartamenti të zakonshëm 1+1.

3. Në lidhje me problematikën e konsumit të ujit dhe të energjisë elektrike, në bazë të përgjigjes së OSSH-së, konstatohet se matësi i energjisë elektrike është vulosur dhe sistemuar më 23.9.2015, ndërsa në bazë të përgjigjes së UKT-së Durrës rezulton se matësi është vendosur dhe vulosur më 8.9.2014. Kjo do të thotë se si sistemi i shpërndarjes dhe matjes së energjisë elektrike të konsumuar ashtu edhe për ujin e pijshëm, përpara vendosjes së matësve, është bërë në bazë të faturimeve aforfe çka do të thotë se faturimi i sasisë së energjisë elektrike apo ujit të pijshëm të harxhuar bëhej në mënyrë fiktive, duke mos u bazuar në dokumente, që tregonin sasinë konkrete të energjisë elektrike apo ujit të pijshëm të harxhuar dhe vlerën përkatëse monetare që duhej paguar. Të ndodhur në këto kushte, prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nuk mund të llogarisnin sasinë e konsumuar dhe vlerën monetare, që duhet të paguanin për energjinë elektrike dhe ujin e pijshëm të konsumuar dhe as nuk e kishin detyrim ligjor ta bënin këtë, për më tepër që përgjegjësinë ligjore për kryerjen e këtij shërbimi e kanë patur dhe e kanë OSSH-ja Durrës dhe UK-ja Durrës. Pra, për sa kohë që në atë periudhë faturimi ka qenë aforfe, (që do të thotë caktimi i një vlerë fiktive që nuk i përgjigjet një matjeje reale të konsumit në kohë reale), pavarësisht se faturimi mund të ketë qenë në vlera minimale, kjo nuk të çon në konkluzionin se apartamenti ka qenë i pabanuar apo është banuar në mënyrë sporadike për shumë pak kohë. Kjo situatë nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi prindërit e

¹ Pika 5 neni 32: “Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelitimit.”

bashkëshortes, as vetë bashkëshorten e subjektit në cilësinë e personit të lidhur, e për më tepër të ngarkojë me përgjegjësi vetë subjektin e rivlerësimit.

4. Në lidhje me shpenzimin e shumës prej 1,000,000 lekësh nga shuma prej 4,400,000 lekësh, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit se ato janë shpenzuar ndër vite nga bashkëshortja e tij për nevoja personale dhe për udhëtimet në Greqi tek prindërit janë bindëse. Ato janë shpenzime të kryera vetëm nga bashkëshortja e subjektit për nevojat e saj personale dhe për udhëtimet në Greqi tek prindërit e saj, çka konfirmohet edhe nga sistemi *TIMS* dhe nuk vërtetohet fakti nëse ato janë përdorur për shpenzime familjare, pra, përfshirë edhe vetë subjektin apo të jenë kryer investime madhore në dobi të familjes së subjektit të rivlerësimit.
5. Në lidhje me provimin e mundësisë së krijimit të këtyre të ardhurave në vlerën 4.440.000 lekë me burime të ligjshme nga personi i lidhur, bashkëshortja e tij, si dhe mbi mosdeklarim nga subjekti në deklaratat periodike vjetore lidhur me pakësimin e gjendjes *cash* të deklaruar në vitin 2009 nga personi i lidhur, si dhe mosdeklarim në deklaratën *Vetting* mbi shumën, përdorimin e tyre për të mbuluar shpenzime të familjes, si dhe tjetërsimin/kthimin e pretenduar të shumës nga subjekti, duke ngritur dyshime tek shumica e trupit gjykues mbi fiktivitetin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me deklarimin e tyre gjatë të gjithë viteve, paraqes kundërshtimet e mia si më poshtë:
 - a) Marrëdhënia e qirasë si dhe përfitimi nga kjo marrëdhënie e shumës prej 4,400,000 lekësh nga prindërit e bashkëshortes, vërtetohet bindshëm si nga deklarimi për herë të parë i pasurisë, deklarimi i përfitimit të të ardhurave të tjera nga qiraja në vazhdimësi nga viti 2010-2013 dhe nga argumentet e dhëna më sipër në pikat 2 dhe 3;
 - b) Është i vërtetë fakti se subjekti i rivlerësimit si dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja e tij, nuk kanë arritur të provojnë burimin e ligjshëm të të ardhurave nga qiraja, por pavarësisht kësaj duhet të mbajmë në konsideratë se:
 - i. shuma prej 4,400,000 lekësh është në pronësi të prindërve të personit të lidhur me të, bashkëshortes së subjektit, e cila ka qenë vetëm në ruajtje nga ana e saj;
 - ii. kjo shumë është krijuar para fillimit të detyrës nga ana e subjektit;
 - iii. historia e krijimit, administrimit dhe kthimit të kësaj shume është një marrëdhënie e posaçme e personale prind – fëmijë (bashkëshortja e subjektit), e cila nuk përfshin subjektin e rivlerësimit si person apo dhe të ardhurat e tij familjare;
 - iv. shuma prej 1,000,000 lekësh e deklaruar përgjatë hetimit si e përdorur nga bashkëshortja e subjektit, është përdorur për nevoja të saj personale dhe për udhëtime të saj personale në Greqi tek prindërit. Kjo shumë nuk provohet se është përdorur për nevoja të familjes së subjektit dhe as të jetë ndërthurur me të ardhurat dhe shpenzimet e familjes së subjektit. Gjithashtu duke marrë në konsideratë faktin se shpenzimi i saj në raport me 4 vitet kur ajo është shpenzuar, nuk e kalon shumën prej 300,000 lekësh në vit, që të përbënte detyrim ligjor për deklarimin e saj nga personi i lidhur me subjektin, bashkëshortja e saj në deklaratimet periodike përkatëse;
 - v. nuk vërtetohet që kjo shumë të jetë përdorur nga familja e subjektit të rivlerësimit për kryerjen e ndonjë investimi madhor, si dhe për përballimin e shpenzimeve familjare;
 - vi. subjekti ka dhënë shpjegime të qarta, të plota dhe bindëse në lidhje me mosdeklarimin e kësaj shume në deklaratën *Vetting*, në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën ***. Në procesverbal është qartësuar nga subjekti se shuma u është kthyer prindërve të bashkëshortes nga ana e saj në vitin 2014.

- Ky deklaram vjen në koherencë me mosdeklarimin nga ana e bashkëshortes së subjektit të të ardhurave nga qiraja për vitin 2014 e në vazhdim;
- vii. deklarimi i kthimit të shumës në vitin 2014 në procesverbalin e datës *** në ILDKPKI, e bën këtë pasuri jo aktive, si për subjektin, ashtu edhe për personin e lidhur me të. Në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*, për rrjedhojë ata nuk kanë pasur detyrimin ligjor për deklarimin e saj qoftë në formën e ruajtjes sikurse duket se është deklaruar për herë të parë ashtu, edhe në formën e shtesave apo pakësimeve.
 - viii. bazuar në faktin se ILDKPKI-ja është institucioni i ngarkuar me ligj për kontrollin e deklarimit të pasurive të subjekteve deklaruese, procesverbali i mbajtur nga ky institucion me subjektin e rivlerësimit më 26.1.2016 përbën deklaram të subjektit para këtij institucioni dhe po ky deklaram, parë në dritën e pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 përbën provë, e cila vjen në harmoni me deklaramet e tjera të subjektit në lidhje me këtë pasuri.

Nga sa më lart, kundërshtoj konkluzionin e shumicës se personi i lidhur me subjektin ka bërë deklaram të rremë në deklaratën periodike vjetore para fillimit të detyrës, të plotësuar nga subjekti i rivlerësimit, si të pabazuar në argumente, prova dhe ligj.

Subjekti i rivlerësimit ka treguar me vërtetësi pasuritë dhe të ardhurat e tij në deklaramet periodike vjetore, si dhe në deklaratën *Vetting*.

Duke marrë në konsideratë faktin se shuma prej 4,400,000 lekësh, është deklaruar në deklaratën për herë të parë të pasurisë në vitin 2009 nga subjekti, gjithashtu edhe në procesverbalin e mbajtur në institucionin e ngarkuar me ligj, ILDKPKI, në datën ***, si të kthyer që në vitin 2014, pra, rezulton e deklaruar të paktën një herë në deklaramat e pasurisë, ajo kurrësi nuk mund të konsiderohet si pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, në kuptim të gërmas “c” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Nuk jam i mendimit se personi i lidhur me subjektin dhe vetë subjekti duhet të justifikojnë burimin e ligjshëm të shumës prej 4,400,000 lekësh, për arsye se kjo shumë nuk ka qenë asnjëherë në pronësi të tyre, nuk është përdorur nga subjekti, nuk ka pasur asnjë ndikim në pasuritë e krijuara nga subjekti, përfshirë dhe shpenzimet familjare si dhe është kthyer përpara plotësimit të deklaratës *Vetting*.

Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja e tij, kanë kryer deklaram të pasaktë të kësaj pasurie, duke e deklaruar atë në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI në datën ***, por jo në kohën e kthimit të saj, DIPP-në e vitit 2014, pasaktësi kjo që vlerësohet e karakterit minimal, që nuk ngarkon me përgjegjësi disiplinore subjektin e rivlerësimit deri në masën që mund të çojë në aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

3. **Të ardhura *cash* në vlerën 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro, në formë dhurate** – deklaruar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në Deklaramen e Interesave Private para fillimit të detyrës datë 29.12.2009, të dhuruara nga prindërit dhe motrat me rastin e martesës. Në lidhje me këtë deklaram të personit të lidhur me subjektin, bashkëshortes së tij, nga shumica e trupit gjykues është konkluduar se:

3.13. “Në përfundim, trupi gjykues çmon se subjekti nuk ka provuar burimin e ligjshëm të dhuruesve dhe mundësitë e tyre financiare për të dhuruar shumën e plotë prej 50,000 euro. Pretendimet e subjektit se këto shuma të dhuruara janë kthyer, mbeten deklarative dhe në vlerësim të trupit gjykues mbeten të paprovuara. Argumentet e pretenduara nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit se nuk kanë shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie dhe fakti se kthimi i tyre nuk gjen pasqyrim në asnjë prej deklaramëve periodike vjetore, në vlerësim, trupi gjykues i bën deklaratimet e personit të lidhur me subjektin të rreme dhe se subjekti i rivlerësimit ka fshehur të dhëna lidhur me këtë pasuri në deklaratën Vetting.

3.14. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë si argument se shuma prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro i ishte dhuruar atyre për blerjen e një shtëpie, e cila nuk ju nevojitej më atyre, prandaj dhe vlerat ishin kthyer mbrapsht. Jo vetëm që nuk ka asnjë dokument ligjor provues mbi kthimin e këtyre shumave, por dhe arsyetimi se shtëpi nuk do të blinin nuk duket bindës, pasi subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë blerë një pasuri (truall+shtëpi) në vitin 2019, ku në vijim kanë ndërtuar një shtëpie banimi private (vilë)².

3.15. Trupi gjykues çmon se mbetet e paprovuar mundësia për krijimin e gjithë shumës prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro, në plotësim të kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe mbetet deklarativ posedimi i kësaj vlere nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja, si dhe mbetet i paprovuar kthimi i këtyre shumave të dhuruesit.

3.16. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka bërë deklaratim të rremë në deklaratën periodike vjetore para fillimit të detyrës, të plotësuar nga subjekti, dhe se ky i fundit nuk ka treguar me vërtetësi pasuritë dhe të ardhurat e tij në deklaratimet periodike vjetore, si dhe në deklaratën Vetting. Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e gurmës “c”, të pikës 5, të nenit 33, pasi ka fshehur në deklaratën Vetting të dhëna lidhur me këtë pasuri.”

Nuk jam dakord me argumentat dhe konkluzionet e shumicës së trupit gjykues, duke arsyetuar si më poshtë:

- a. dhurimi i shumës prej 50,000 eurosh i është bërë personalisht personit të lidhur me subjektin, bashkëshortes së tij, nga prindërit dhe dy motrat, me rastin e martesës së saj me subjektin dhe me qëllimin të dedikuar për të blerë një shtëpi banimi;
- b. ky dhurim është kryer kohë përpara se z. Stoja të bëhej subjekt deklarues dhe është deklaruar nga personi i lidhur me të, bashkëshortja e tij, në deklaratën për herë të parë të pasurisë, duke shuar kështu çdo dyshim se ajo është para e vënë gjatë punës, e dyshuar me burim nga veprimtari korruptive të subjektit;
- c. duke marrë në konsideratë faktin se dhurimi është kryer në një kohë relativisht të largët, viti 2007, përpara fillimit të detyrës nga subjekti dhe në kushtet e një marrëdhënieje të posaçme prind- fëmijë dhe motër me motër dhe për më tepër që dhurimi është bërë në formën e pajës për shkak martese, nuk ka qenë e domosdoshme dokumentimi si dhurim, po ashtu edhe kthimi i kësaj shume;
- d. subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë lloj tagri disponimi, posedimi apo gëzimi mbi shumën prej 50,000 eurosh. Ajo ka qenë në pronësi ekskluzive, personale të bashkëshortes së subjektit deri në momentin e kthimit.
- e. në vitin 2011 subjekti i rivlerësimit ka përfituar në pronësi individuale apartamentin e prindërve të tij, duke siguruar kështu strehimin për familjen e tij.

²Nuk është bërë pjesë e rivlerësimit, pasi nuk është pasuri e deklaruar në deklaratën Vetting.

- f. me përfitimin e apartamentit të prindërve në pronësi të tij, e për rrjedhojë me sigurimin e strehimit për familjen e tij, shuma prej 50,000 eurosh, dhuruar personalisht bashkëshortes së tij nga prindërit dhe motrat e saj e humbi qëllimin për të cilin ishte dhuruar, pra, për sigurimin e strehimit dhe, në këto kushte, kthimi i kësaj shume nga bashkëshortja dhuruesve, përveçse është një veprim i drejtë dhe i moralshëm, është edhe një veprim më se i logjikshëm në kushtet kur tashmë ishte siguruar strehimi.
- g. shuma prej 50,000 eurosh, përgjatë gjithë kohës së disponimit të saj nga bashkëshortja e subjektit, ka mbetur e paprekur. Me të nuk është vërtetuar të jetë kryer asnjë investim madhor nga subjekti dhe bashkëshortja e tij, gjithashtu nga hetimi nuk ka rezultuar që ajo të jetë përdorur për të përballuar ndonjë shpenzim, qoftë familjar apo edhe personal të bashkëshortes së subjektit;
- h. argumenti i shumicës se: “*por dhe arsyetimi se shtëpi nuk do të blinin nuk duket bindës, pasi subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë blerë një pasuri (truall+shtëpi) në vitin 2019, ku në vijim kanë ndërtuar një shtëpie banimi private (vilë)*³”, nuk qëndron për arsye se nga momenti kur subjekti ka përfituar apartamentin e banimit në vitin 2011 e deri ku ka blerë pasurinë e llojit “truall” (truall + shtëpi) në vitin 2019, kanë kaluar 8 vjet, çka nënkupton se familja është shtuar, fëmijët janë rritur dhe secili prej anëtarëve ka nevojë për hapësirën e duhur të jetesës. Qëllimi për të cilin u mor dhurata, blerja e një shtëpie për strehim, është realizuar nga vetë subjekti i rivlerësimit në vitin 2011 dhe kthimi i kësaj shume prindërve të bashkëshortes së subjektit dhe mospërdorimi i saj nuk lidhet në asnjë formë, mënyrë apo logjikë me faktin e investimit në blerjen e një pasurie tjetër të paluajtshme në vitin 2019;
- i. në lidhje me konkluzionin se personi i lidhur me subjektin nuk ka deklaruar burimin e ligjshëm të krijimit të shumës së dhuruar prej 50,000 eurosh, pavarësisht faktit se prindërit e bashkëshortes e justifikojnë mundësinë e dhurimit prej 18,000 eurosh, njëra prej motrave ka pasur të ardhura familjare vetëm për periudhën 2007 – korrik 2007, në shumën rreth 40,000 euro dhe motra tjetër për periudhën 2004 – korrik 2007, në shumën rreth 45,500 eurosh, shuma të cilat në mënyrë kumulative duket se janë të mjaftueshme për të kursyer secila nga 16,000 euro, kjo përforcuar me faktin se të dyja motrat, bashkëshortët e tyre kanë historik punësimi në shtetin italian që prej vitit 1996 dhe 2002, jam i mendimit se si subjekti, ashtu edhe bashkëshortja e tij, nuk kanë pasur detyrim ligjor për të justifikuar burimin e ligjshëm të një pasurie, që është krijuar përpara deklarimit fillestar të pasurisë së subjektit, nuk ka asnjë lidhje me subjektin e rivlerësimit, nuk është përdorur për asnjë investim madhor apo edhe për shpenzime familjare nga ana e subjektit dhe e personit të lidhur me të, është vërtetuar në mënyrë bindëse kthimi i kësaj shume në vitin 2014 dhe nuk ka qenë detyrim deklarimi i saj në deklaratën *Vetting*.
- j. argumentet dhe konkluzionet e mia në lidhje me mosdeklarimin e dhuratës prej 50,000 eurosh në deklaratën *Vetting*, deklarimin e rremë dhe fshehjen e pasurisë janë po të njëjta me ato që kam pasqyruar në pikat vi, vii, viii dhe 2 paragrafët në vazhdim që kanë të bëjnë me pikën 2 “**Kursime cash në vlerën 4,440,000 lekë**”.

Në përfundim, në lidhje me këtë pasuri të deklaruar nga personi i lidhur me subjektin, bashkëshortja e tij, konstatoj se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, bashkëshortja e tij, kanë kryer deklarim të pasaktë të kësaj pasurie, duke e deklaruar atë në procesverbalin e

³Nuk është bërë pjesë e rivlerësimit, pasi nuk është pasuri e deklaruar në deklaratën *Vetting*.

mbajtur nga ILDKPKI në datën ***, por jo në kohën e kthimit të saj DIPP-në e vitit 2014, pasaktësi kjo që vlerësohet e karakterit minimal, që nuk ngarkon me përgjegjësi disiplinore subjektin e rivlerësimit deri në masën që mund të çojë në aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

Në asnjë veprim të kryer, si nga subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe personi i lidhur me të, bashkëshortja e tij, nuk ka elemente që të çojnë në konkluzionin se është cenuar besimi i publikut.

VLERËSIMI TËRËSOR

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet, rrethanat dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe në vlerësimin tërësor të procedurave në lidhje me këtë kriter, unë, në cilësinë e anëtarit në pakicë/kundër, arrij në përfundimin se subjekti i rivlerësimit z. Gentian Stoja ka arritur një nivel të besueshëm edhe për kriterin e pasurisë.

PËR KËTO ARSYE,

Unë, si anëtar në pakicë, vlerësoj se vendimi i shumicës së trupit gjykues, që ka shkarkuar subjektin e rivlerësimit Gentian Stoja, bazuar në germën “c” të pikës 1 të nenit 58, si dhe në pikat 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, nuk është i drejtë.

Bazuar në argumentet dhe konkluzionet e dhëna më sipër nga unë, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues në pakicë, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit Gentian Stoja:

- a) ka kryer deklaratim të mjaftueshëm dhe në vlerësim tërësor të saktë të pasurisë, duke konstatuar pasaktësi të karakterit minimal, duke përmbushur kushtet ligjore të germës “a” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016; Nga analiza financiare rezulton se me të ardhurat e fituara ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të blerë pasuritë, për të krijuar likuiditetet dhe për të kryer të gjitha shpenzimet e jetesës të evidentuara gjatë periudhës së rivlerësimit 2009 – 2016, në shumën -512.285 lekë, të cilën, në bazë të parimit të proporcionalitetit e vlerësoj si vlerë minimale, duke mos prodhuar pasoja të tilla, që mund të çojnë në konkluzionin se ndodhet përpara një deklaratimi të pamjaftueshëm dhe, për rrjedhojë, në aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, referuar nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016;
- b) ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas nenit 59/b të ligjit nr. 84/2016;
- c) konsiderohet se ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, duke përmbushur kushtet ligjore të germës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë krijoj bindjen e bazuar në argumente, prova dhe në ligj, se shumica e trupit gjykues nuk duhet të kishte disponuar me shkarkimin nga detyra të këtij subjekti, por me konfirmimin e tij në detyrë.

Olsi Komici
Anëtar në pakicë/kundër